



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. <u>2-D/DPK</u>	Br. Prot. <u>01-1677/14</u>
Dep.	Prot No.
Nr. l faq.	Data
Broj stranica <u>02</u>	Datum <u>14-05-2014</u>
Nr. pages	Date
	PRISHTINË



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	12.05.2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Mehmet TINOVA Zyrtar i Prokurimit në Kompaninë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
CC:	z. Avdulla HAXHIU Kryeshef Ekzekutiv në Kompaninë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin " Furnizim me derivate të naftës për KMDK "



**I nderuari, z. TINOVA ,**

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin " Furnizim me derivate të naftës për KMDK " me nr. të prokurimit: KMDK- 14-007-111 (ri-tender), Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

**OPINION**

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues (në tekstin e mëtejme A.K), që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin "Furnizim me derivate të naftës për KMDK" në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

## A r s y e t i m

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë, përmes zyrës së prokurimit ka përgatitë Njoftimin për Kontratë me titull “Furnizim me derivate të naftës për KMDK“ ( ri-tender ) me nr. të prokurimit: KMDK- 14-007-111, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.07.04.2014, në Procedurë të Hapur. Divizioni për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik, pranë Agjencisë kundër Korrupsionit sipas detyrës zyrtare ka identifikuar dhe trajtuar këtë procedurë të prokurimit. Gjatë trajtimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit për këtë aktivitet të prokurimit në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, Agjencia kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në pajtueshmëri të plotë me dispozitat e Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

Në njoftimin për kontratë i cili është publikuar me dt.29.04.2014 dhe dosjen e tenderit, tek rubrika kapaciteti ekonomik dhe financiar pika a) është kërkuar raporti apo dëshmia financiare nga një Bankë, lidhur me qarkullimin financiar, **për dy vitet e fundit (2012,2013)**, ndërsa tek rubrika kapaciteti teknik dhe profesional pika a) ka kërkuar, listën e kontratave të realizuara **gjatë dy viteve të fundit (2012,2013)**.

**Autoriteti kontraktues mundet të kërkojë një listë që liston furnizimet kryesore relevante të OE që specifikon: produktet e përfshira, shumën kontraktuale, datën dhe pranuesin. Gjithashtu autoriteti kontraktues mund të kërkojë vlera minimale referenca në lidhje me furnizimet në 3 vitet e fundit, por nuk lejohet më pakë se 3 vite ose më shumë.**

Kufizimi i qarkullimit financiar në 2 vitet e fundit, e kufizon apo e zvogëlon konkurrencën në mesin e operatorëve ekonomik, prandaj konsiderohet shkelje e nenit 7 e LPP-së.

Agjencia kundër Korrupsionit, gjithashtu ka vërejtur se kërkesa e njësisë kërkuese nuk është përpiluar dhe lejuar në formën zyrtare.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi, 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare, nenin 69 Aftësia Teknike dhe Profesionale të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042, 9 Funksionet e Njesisë së Kërkesës, nenin 23 Kriteret e përzgjedhjes të Udhëzuesit Operativ dhe nenin 5 Gjendja ekonomike dhe financiare e Udhëzimit administrativ nr.02/2014 të KRPP-së

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit, rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt!

